

LIGJ
Nr. 40/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9870, DATË 4.2.2008,
“PËR STANDARDIZIMIN”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë:

“5. DPS-ja është Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika Kombëtare e Referimit në OBT dhe në CEFTA për projektstandartet, projektregullat teknike dhe projektprocedurat e vlerësimit të konformitetit me ndikim në tregti.”.

b) Në paragrafin e dytë, fjalët “pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për çdo notifikim të saj pranë OBT-së.” zëvendësohen me fjalët “pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, për çdo notifikim të saj pranë OBT-së dhe CEFTA-s.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është Administratori Kombëtar i Regjistrimit për Lëshuesit (NRA/I).”.

Neni 2

Në nenin14 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “ë”, pas fjalës “informacioni” shtohen fjalët “për tregun e brendshëm dhe atë unik europian”.

2. Në fund të shkronjës “f” shtohen fjalët “dhe Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Europën Qendrore (CEFTA).”.

3. Pas shkronjës “P” shtohet shkronja “f/1” me këtë përmbajtje:

“f/1) zbaton detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i direktivave dhe i rregulloreve të Bashkimit Europian për standardizimin dhe fushat që lidhen me të, si dhe është pikë kontakti për dhënien e informacionit për disa nga produktet që vendosen në treg.”.

Neni 3

¹ Ky projektligj është në përputhje dhe për zbatimin e kërkesave të standardit shqiptar, i cili specifikon strukturën e të dhënave për sistemet e telematikës në transportin e qarkullimin rrugor - Identifikimi automatik i automjeteve dhe pajisjeve - Kodifikimi dhe struktura e të dhënave, SSH EN ISO 14816:2005 (ose me çdo amendim apo ripublikim të tij në të ardhmen).

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

Miraturar në datën 23.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11470, datë 30.4.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.